



PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 16.08.2024 në Shkollën Filllore "Ilaz Thaçi" paralelja në fshatin Seçisht. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 13:30 prezent ishin 23 qytetarë. Prezent ishte Kryetari i Komunës z.Mehmet Ballazhi.

Takimin e kryesoj Drejtoresha Buxhet dhe Financa znj.**Lindita Ballazhi**.

Rendi i Punës

1. Projekt Buxheti për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027.

Lindita Ballazhi para se me vazhduar me prezantimin e buxhetit fillimisht kërkoj nga Kryetari i Komunës për një fjalë përshëndetëse, pastaj do të bëjë prezantimin e buxhetit.

Mehmet Ballazhi është obligim ligjorë që të organizojmë dëgjim buxhetorë për planifikimin buxhetorë për vitin 2025 dhe parashikimet për vitin 2026-2027. Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 € dhe në kuadër të këtij buxheti janë kategoritë buxhetore për paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, investime kapitale që do të thotë se shumica e buxhetit është në paga ndërsa 40 % e buxhetit për projekte. Në bazë të kërkesave të qytetarëve që janë më prioritare përcaktohen edhe projektet. Në materialet të cilat janë para jush janë të radhitura projektet të cilat janë të planifikuara e që prej tyre ka edhe projekte të cilat janë të planifikuara edhe për fshatin Seçishtë. Pas prezantimit të buxhetit nga drejtoresha për financa ju mund të parashtroni kërkesat e juaja të cilat mendoni se janë prioritare për këtë fshat.

Lindita Ballazhi Buxheti paraqet një instrument financiar apo një plan njëvjeçar për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore të Organizatës Buxhetore. Fazat nëpër të cilat i kemi kaluar deri në hartimin e buxhetit janë:

- Themelimi i 2 grupeve punuese: Grup punues për hartimin e dëgjimeve buxhetore dhe Grupi punues për hartimin e KAB-it 2025-2027.
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 01/2025 me kufijtë fillestar buxhetor,
- Hartimi i KAB-it me grupin punues,
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore për KAB 2025-2027,
- Miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i KAB-it në Departamentin e Buxhetit - MFPT,
- Pranimi i Qarkores Buxhetore 02/2025 me kufijtë final buxhetor,
- Hartimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Mbajtja e Dëgjimeve Buxhetore për Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,

- Dorëzimi i Draft Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 para datës 01.09.2024 në Kuvend Komunal,
- Miratimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Kuvend Komunal,
- Dorëzimi i Buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027 në Departamentin e Buxhetit - MFPT.

Buxheti për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ky buxhet është ndarë në kategoritë buxhetore. Për paga dhe shtesa buxheti i planifikuar është në shumë prej 2,188,542.00 €, mallra dhe shërbime 584,500.00 €, shpenzime komunale 94,000.00 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00 €, investime kapitale 605,415.00 €.

Sa i përket listës së projekteve kapitale, i kemi listuar të gjitha projektet të cilat janë miratuar nga Asambleja Komunale në KAB 2025-2027, po ne jemi të hapur edhe për propozime të reja. Më pas do të hartojmë Listën e propozimeve të qytetarëve dhe të njëjtën listë do ta dorëzojmë së bashku me Buxhetin në Kuvend Komunal për shqyrtim dhe aprovim të mëtutjeshëm.

Mevludin Kuka si këshill i fshatit i kemi paraparë disa projekte në vazhdimësi varësisht prej mundësive buxhetore. Rregullimi i kroit të fshatit te burimi. Ndriçimi publik . Rregullimi i trotuareve. Rregullimi i rrugës prej burimit deri në Lepenc. Rruga e Llokës . Rregullimi i rezervarit të ujit në vendin e quajtur Sarasell. Ndërtimi i aneksit për këmbësorë te Ura e Seçishtës. Ndërtimi me zhavorr i rrugës prej gurthyesit deri në vorba.

Femi Shkreta vendosja e policëve të shtrirë dhe kamerave për shkak se i kanë dëmtuar drunjët dekorativ.

Demir Thaçi rregullimi i shtyllave elektrike në fshatin Krivenik. Rrugicat me kupëza betoni mi shtuar. Rregullimi i pusetave atmosferike dhe i asfaltit të rrugës së fshatit Krivenik në pjesët e dëmtuara është mirë që të hiqen pengesat që janë vendosë në rrugë për shkak se po dëmtohen veturat. Është mirë që me i larguar veturat të cilat po parkohen në rrugë.

Zulkani Shkreta propozoj që të bëhet muri mbrojtës deri te varrezat e fshatit.

Lindita Ballazhi a keni edhe ndonjë propozim përveç këtyre propozimeve , nëse nuk ka propozimet që u parashtruan do t'i analizojmë si ekzekutiv dhe do t'i përcjellim për Kuvend.

Debati përfundoi në ora 14:38.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Drejtoresh për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi


